



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 24, datë 07.10.2021

MBI

"MIRATIMIN E RREGULLORES TË FUNKSIONIMIT TË NJËSISË SË SIGURIMIT TË BRENDSHME TË CILËSISË, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE"

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, mbështetur në Ligjit nr. 80/2015, për "Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 319, datë 13.09.2021 "Për miratimin e Statutit të Universitetit të Arteve", pasi diskutoi rreth propozimit të rregullores të funksionimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshme të Cilësisë në UART, përcjellë nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin e Rektorit me nr. 153, datë 17.09.2021, me votim të hapur,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores së funksionimit të Njësisë së Sigurimit të Brendshme të Cilësisë, në Universitetin e Arteve.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot CAUSHI

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Artan PEQINI

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Arben LLOZI

Prof. Ilir MARTINI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Asoc. Dorian ÇENE

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Asoc. Kastriot TUSHA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Endri SINA

Prof. Asoc. Gjergj PREVAZI

Prof. Asoc. Albes FUSHA

Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI


Dea SHUBLEKA (Studente FAB)

Sindi ZDRAVA (Studente FM)



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE



RREGULLORE E FUNKSIONIMIT

TË NJËSISË SË SIGURIMIT

TË BRENDSHËM TË CILËSISË



Miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 24 datë 07/10/2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 1

Baza ligjore

Rregullorja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC), mbështetet në legjislacionin në fuqi, në Standardet për Sigurimin e Cilësisë, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 531, datë 11.09.2019 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL), Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Arteve (UART), si dhe në të gjithë aktet normative që kanë këtë objekt.

Neni 2

Objekti

Objekti i kesaj Rregulloreje është:

- të përcaktojë procedurat dhe metodat e sigurimit të cilësisë në nivel institucional;
- vlerësimit të cilësisë së mësimdhënësve dhe kërkimit artistik shkencor;
- ndjekjen e vazhdueshme të ecurisë dhe vlerësimit të studentëve në veprimtarinë e tyre artistike-mësimore;
- shtrirjen e sistemit të sigurimit të cilësisë në të gjitha hallkat organizative dhe njësitë kryesore dhe bazë të UART.

Neni 3

Qëllimi i SBC

Qëllimi i SBC është:

- Rritja e vazhdueshme e cilësisë së drejimit të UART, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të politikave dhe strategjive afatshkurtra dhe afatgjata.
- Rritja e vazhdueshme e cilësisë së formimit të studentëve duke i ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat bashkëkohore të mësimdhënies.
- Nxitja e studentëve për të qenë aktivë në dhënien e opinioneve mbi çështjet aktuale.
- Zbatimi i metodave të sakta në sigurimin e cilësisë në një mënyrë të lartë profesionale, do të ndikojë në gjenerimin e marrëdhënieve të besimit në arsimin e lartë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Neni 4

Ngritja dhe funksionimi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë (SBC) funksionon pranë Zyrës mësimore & Kurikulës, Informimit të Studentëve, Karrierës dhe Alumni, dhe është përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë në UART dhe të programeve të studimit që ajo ofron.

SBC ka për detyrë të kryejë vlerësimin dhe raportimin periodik sipas fushave të veprimit të sigurimit të cilësisë të përcaktuara në aktet normative në fuqi, në përputhje me standartet e cilësisë. SBC ka akses të plotë në grumbullimin e të dhënave drejtpërdrejtë në njësitë kryesore të UART, apo nëpërmjet organizimit të vlerësimit periodik sipas fushave të veprimit të sigurimit të cilësisë. Rezultatet apo edhe analizat e nxjerra, SBC i raporton në mënyrë indirekte nëpërmjet Zv. Rektorit për anën mësimore, autoritetit më të lartë drejtues në UART.

Funksionet e SBC janë në përputhje me kërkosat kombëtare dhe evropiane të sigurimit të cilësisë. SBC krijon bazën dokumentare si:

- a) udhëzime,
- b) pyetësorë vlerësimi për stafin akademik;
- c) pyetësorë vlerësimi për stafin administrativ;
- d) pyetësorë vlerësimi për studentët;
- e) mbledh, administron dhe përpunon të dhëna apo dhe informacione bazuar në procese dhe rezultate;
- f) evidenton çështje dhe jep rekomandimet përkatëse;
- g) bashkërendon dhe koordinon proceset e vlerësimit të cilësisë kur procesi kryhet në nivel njësie bazë apo njësie kryesore;
- h) nxit kërkimin për zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë duke vlerësuar përdorimin e mësimdhënies moderne, të mësuarit dhe metodat e vlerësimit të studentëve, për të promovuar dhe adoptuar metoda të sakta duke vendosur klimë besimi ndërmjet pjesëve kryesorë të interesuara.

Neni 5

Përbërja e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SBC)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Përbërja e SBC është sipas përcaktimit në Statutin e UART.

Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë mbulohet nga 1 (një) specialist i/e cili merret dhe është përgjegjës direkt për koordinimin e Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC) në rang Institucional.

Komisionit i SBC përbëhet nga:

- a) 1 (një) specialist i Sigurimit të cilësisë në UART
- b) Nga 1 (një) përfaqësues për secilin Fakultet të UART,
- c) 1 (një) student.

Vetëm në rastet kur institucioni i nënshtron akreditimit institucional periodik dhe akreditimit për herë të parë apo periodik të programeve të studimit që ofron UART, kur është e nevojshme, thirret një ekspert i jashtëm.

Anëtarët e Komisionit, pjesë e personelit akademik janë minimalisht me gradën shkencore "Doktor", me një përvojë 5 (pesë) vjeçare në mësimdhënie.

Anëtarë i Komisionit, pjesë e studentëve të UART duhet të jetë me mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë).

Neni 6

Detyrat e Komisionit i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC)

KSBC planifikon të gjitha aktivitetet lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Konkretnisht:

- a) Bën mbledhjen e të dhënave sipas treguesve sasiorë dhe cilësorë për institucionin dhe programet e studimit.
- b) Organizon vlerësimin e vazhdueshëm periodik të sigurimit të cilësisë.
- c) Krijon një sistem dokumentacioni për sigurimin e cilësisë duke përditësuar procedurat e ndryshme në funksion të sigurimit të cilësisë, formularët tip, etj..
- d) Përmirëson metodologjinë e punës për arritjen e qëllimeve dhe objektivave.
- e) Bën vlerësimë për stafin akademik duke filluar me:
 - i. pyetësorët e studentëve;
 - ii. merr në konsideratë vlerësimet e performancës së lektorëve mbi mësimdhënien,





- iii. kërkimin artistike-shkencor,
- iv. mbështetjen administrative në njësinë përkatëse.
 - f) Bën përpunimin e pyetësorëve.
 - g) Nxit pjesëmarrjen dhe angazhimin për zbatimin e rekomandimeve nëpërmjet plan veprimeve të detajuara dhe të argumentuara.
 - h) Bashkërendon dhe asiston procesin e vlerësimit të brendshëm në nivel institucional, nivel njësie kryesore dhe njësie bazë.
 - i) Merr pjesë në grupet e vlerësimit të brendshëm (grupe ad-hoc) që ngrihen nga titullari i Institucionit, për përgatitjen e raportit të vlerësimit të brendshëm.
 - j) Ruan dhe përmirëson njohuritë teknike dhe profesionale duke marrë pjesë në trajnime të ndryshme që lidhen me cilësinë në arsimin e lartë.
 - k) Bashkëpunon me institucionet e arsimit të lartë për procesin e vlerësimit dhe akreditimit.
 - l) Bashkëpunon me njësitë apo komisionet e sigurimit të cilësisë në institucionet e tjera të arsimit të lartë për të shkëmbyer përvojën dhe për të nxitur bashkëpunimet ndërinstitucionale.
 - m) Harton raportin e vlerësimit të cilësisë në nivel institucional çdo 2 (dy) vite akademike, duke ja përcjellë titullarit të UART dhe Senatit Akademik.
 - n) Etj..

Neni 7
Kontributi i KSBC në UART

KSBC harton, jep sugjerime për përmirësimin e punës përritjen dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë për të ardhmen në drejtimet e mëposhtëm:

- a) në fuqizimin dhe ngritjen e nivelit të punës në Fakultete dhe Departamentet përkatëse;
- b) në lidhjen reciproke midis mësimdhënieve dhe punës artistike-shkencore;
- c) në atmosferën e përgjithshme të mësimdhënieve;
- d) në mbështetjen me shërbime të stafit akademik dhe të studentëve;
- e) në metodat e vënies së studentit në qendër të mësimdhënieve;
- f) në metodat e mësimdhënieve;
- g) në rezultatet në mësim nxënie;



- h) në realizimin e punës artistike-shkencore;
- i) në fleksibilitetin dhe sigurimin e cilësisë;
- j) në metodën e vlerësimit;
- k) në mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve;
- l) në shtimin dhe konsolidimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UART me institucione të larta arsimore publike dhe jo publike kombëtare dhe ndërkombëtare;
- m) në rritjen dhe konkretizimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione/subjekte/etj., në funksion të zhvillimit të praktikave mësimore dhe mundësive për punësim të studentëve të UART.

Neni 8

Komunikimi dhe Forma e monitorimit të sigurimit të cilësisë

Fillimi i procesit të vlerësimit të cilësisë, i komunikohet të gjitha njësive që do të vlerësohen që në momentin e fillimit të tij.

Për të menaxhuar dhe monitoruar sigurimin e cilësisë nevojitet hartimi i instrumenteve/formave të përshtatshme për realizimin, mbledhjen, analizën e rezultateve, formulimin e rekomandimeve dhe diskutimin e tyre në njësi bazë dhe kryesore. Raportet e monitorimit u komunikohen organeve, strukturave dhe autoriteteve përkatëse të UART. Raportet e vlerësimeve të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të marra nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, u komunikohen individualisht individëve.

Të dhënat e monitorimeve dhe vlerësimeve përdoren për: përgatitjen e raporteve të vlerësimit të brendshëm; për vlerësimin në kuadër të akreditimit; për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit, të mësimdhënies, të kërkimit artistike-shkencor, të shërbimeve dhe të menaxhimit; për përmirësimin e performancës së personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.

Neni 9

Vlerësimi i brendshëm dhe rivlerësimi i sigurimit të cilësisë

Vlerësimi i brendshëm dhe rivlerësimi i sigurimit të cilësisë përfshin:

1. Vlerësimin e cilësisë së programeve të studimit,





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Cilësia e programeve të studimit realizohet nëpërmjet përgatitjes së standardeve dhe modaliteteve të përshtatshme. Institucioni duhet të monitorojë rregullisht efektivitetin e programeve që ofron. Institucioni duhet të përdorë mekanizma zyrtarë për miratimin, vlerësimin periodik dhe monitorimin e programeve dhe diplomave të tyre. Monitorimi mund të mbështetet: në raportet e vlerësuesve të jashtëm; komentet nga stafi akademik; komentet nga studentët; komentet nga ALUMNI; progresi i studentëve; etj.

2. Vlerësimin e cilësisë së procesit mësimor,

Vlerësimi i cilësisë së procesit mësimor sigurohet nëpërmjet:

- i. Organizimit, përgatitjes dhe ndarjes së procesit mësimor, në mënyrë që studenti:
 - a) Të zhvillojë aftësitë komunikuese dhe interakte;
 - b) Të aplikojë koncepte teorike themelore;
 - c) Të ketë përgjegjshmëri nëse është anëtar në një Komision/ekip, etj.;
 - d) Të zhvillojë aftësitë e mendimit dhe të zgjidhjes së problemeve;
 - e) Të zhvillojë aftësitë e integrimit të njohurive;
 - f) Studentët duhet të vlerësohen duke përdorur kriterë, rregulla dhe procedura të cilat zbatohen në mënyrë të vazhdueshme e të përhershme.
- ii. Sigurimit të cilësisë së stafit akademik dhe jo akademik;
- iii. Sigurimit të raporteve profesionale në punë me studentët;
- iv. Përsosmërinë e dhënies së mësimit;
- v. Sigurimin e numrit të nevojshëm të stafit akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar;
- vi. Sigurimin e kapaciteteve infrastrukturore në funksion të procesit mësimor;
- vii. Sigurimin e literaturës së nevojshme dhe ndihmëse në bibliotekë si dhe të gjithë hapësirës së mjaftueshme në to.

3. Vlerësimin e punës akademike dhe artistike-shkencore.

I gjithë personeli akademik, me qëllim sigurimin e cilësisë së punës artistike-shkencore duhet të angazhohet në krijimin, përgatitjen dhe realizimin e programit të studimit në përputhje me:

- a) Strategjinë dhe politikën e UART;
- b) Nevojat dhe pritshmërinë e shoqërisë;
- c) Praktikën më të mirë të institucioneve të huaja arsimore dhe artistike-shkencore;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- d) Disponimin e burimeve të brendshme dhe të jashtme për realizimin e programeve dhe projekteve konform standardeve;
- e) Numrin e publikimeve artistike shkencore;
- f) Numrin e projekteve të aplikuara dhe numrin e projekteve të realizuara (kombëtare dhe ndërkombëtare);
- g) Pjesëmarrjet në seminare, konferanca, aktivitete artistike, këshilla shkencore, borde të ndryshme, etj.;
- h) Numrit të pjesëmarrësve në trajnime, aktivitetet artistike, aktivitetet artistike-shkencore, etj..

Institucioni duhet të sigurohet që stafi i përfshirë në mësimdhënien e studentëve të jetë i kualifikuar dhe i aftë. Stafi duhet të jetë i disponueshëm ndaj personave/grupeve/individëve që ndërmarrin vlerësimet e jashtme dhe komenteve në raporte por dhe më gjerë.

Neni 10

Hartimi i Raportit të KSBC

Me qëllim përfitimin maksimal nga procesi i vlerësimit të cilësisë, është e rëndësishme që rapporti të plotësojë nevojat e identikuara të lexuesit. Raporti mund ti drejtohet grupeve të ndryshme të lexuesve dhe kjo kërkon ti kushtohet kujdes i veçantë strukturës, përbajtjes, stilit dhe etikës të të shkruarit.

Raporti duhet të ristrukturohet në mënyrë të tillë që të përfshijë:

- a) përshkrime;
- b) analiza (që përfshijnë të dhëna të fushës përkatëse);
- c) përfundime,
- d) urdhra dhe rekomandime.

Raporti duhet të përbajë shpjegime paraprake të mjaftueshme për të bërë të mundur që çdokush që e lexon të kuptojë qëllimet e vlerësimit/rivlerësimit, formën e tij dhe kriteret e përdorura në marrjen e vendimeve. Pikit kyçë dhe rekomandimet duhet të janë evidente dhe lehtësish të dallueshme.

Neni 11





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Vlerësimi i jashtëm i sigurimit të cilësisë

Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) me kërkesë të Rektorit të UART, pas përfundimit të vlerësimit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Procedurat për sigurimin e jashtëm të cilësisë duhet të marrin në konsideratë efektivitetin e proceseve për sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, është e rëndësishme që politikat dhe procedurat e brendshme të vlerësohen me kujdes, për të përcaktuar si dhe në ç ‘shkallë janë plotësuar standardet. Nëse Institucioni arrin të tregojë efektivitetin e proceseve të vlerësimit të brendshëm për sigurimin e cilësisë dhe nëse këto procese sigurojnë cilësinë dhe plotësojnë standardet plotësisht, atëherë procesi i vlerësimit të jashtëm mund të jetë më pak intensiv nga sa mund të parashikohet.

Vlerësimi i jashtëm kryhet dhe realizohet nga Ekspertë të pavarur, vendas dhe të huaj sipas listës së ekspertëve të jashtëm të ASCAL të miratuar nga Bordi i Akreditimit, në dijeni të së cilës është edhe MASR.

Neni 12

Pyetësorët e stafit akademik dhe të studentëve

Pjetësorët e stafit akademik dhe të studentëve janë format e përdorshme për realizimin e proceseve të sigurimit të cilësisë, por jo vetëm. Pjetësorët përgatiten nga KSBC dhe duhet të përmbajnë:

- Pjetje të cilat janë të rëndësishme për identifikimin e dhënies efektive të mësimit, pa krijuar paragjykime.
- Të kenë një numër të kufizuar pyetjesh dhe të lejojnë dhënien e mendimeve specifike të tyre.
- Çfarë është ndryshuar nga rezultati i pyetësorëve të fundit.

Nëpërmjet pyetjeve, studentët duhet të shprehin thjesht dhe qartë:

- i. angazhimin e tyre në procesin e të nxenit;
- ii. mënyrën e mësimdhënies së pedagogëve të lëndëve;
- iii. marrëdhëniet reciproke pedagog-student;
- iv. trajtimin e metodave që përdorin pedagogët për të arritur rezultatet e të nxenit të përcaktuara në një lëndë apo modul të caktuar;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- v. tu jepet mundësia mbi dhënien e opinionit të tyre për gjëra apo dukuri që i shqetësojnë dhe që kërkojnë të përmirësohen/ ose ndoshta të realizohen për herë të parë.

Neni 13

Të dhënat statistikore dhe përpunimi i tyre

Universiteti i Arteve disponon të dhëna si: nivelin e kalueshmërisë së studentëve, nivelin e diplomimit, diversitetin e programeve që ofron, ndërkombëtarizimin, etj. Këto të dhëna të cilat mblidhen dhe ruhen në nivel Fakulteti i dërgohen KSBC e cila bën analizën e tyre. Kjo analizë përfshin:

- a) Ecurinë e studentëve dhe nivelet e suksesit;
- b) Mundësitë e punësimit të të diplomuarve;
- c) Raportin staf akademik/student;
- d) Efektivitetin e stafit akademik;
- e) Ndjekjen e studentëve pas përfundimit të studimeve;
- f) Nivelin e largimit të studentëve nga shkolla dhe arsyen e këtij largimi;
- g) Etj..

Neni 14

Procedurat vazhduese dhe masat për përmirësimin e cilësisë

Proceset e sigurimit të cilësisë të cilat përbajnjë rekomandime për veprime ose të cilat kërkojnë një plan pasues veprimi, duhet të kenë një procedurë vazhduese të paracaktuar e cila zbatohet në mënyrë të vijueshme.

Sigurimi i cilësisë kërkon të sigurojë vazhdimësinë dhe të nxisë përpjekje të vazhdueshme për të bërë një punë më të mirë. Sigurimi i cilësisë nuk përfundon me hartimin e raportit, por duhet të përfshijë një procedurë të strukturuar vazhduese për të bërë të mundur që rekomandimet të shoqërohen me planet e duhura të veprimit dhe të përshtatshme, që hartohen dhe zbatohen. Objktivi është që të sigurohet që në sferat e identikuara për përmirësim, të veprohet me shpejtësi dhe të nxitet përmirësimi i mëtejshëm.

Rektori dhe Senati akademik, në bazë të raportit periodik të KSBC, propozon dbe harton plan





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

veprimin për përmirësimin e mëtejshëm të sigurimit të cilësisë.

Neni 15

Ndryshimi i Rregullores

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullorej bëhen në përputhje me përcaktimet në Statutin e UART.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik.

